

UDHËZIM
Nr.3, datë 28.7.2004

PËR ADMINISTRIMIN E UJIT TË PIJSHËM

Në mbështetje të vendimit nr.236, datë 10.5.1993, të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë” dhe vendimit nr.550, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikave “Decentralizimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet” dhe masat për zbatimin e tij””.

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Mënyrat dhe format e dhënies së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve zgjidhen nga pushteti vendor në përputhje me kushtet specifike dhe interesat e komunitetit. Format për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, janë të përcaktuara me vendimin nr. 550, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikave “Decentralizimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet” dhe masat për zbatimin e tij””.

2. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të përdorura bëhet nga sh.a. ujësjellës-kanalizime, koncensionari si shoqëri menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, të licencuara në bazë të kontratave të shitjes që lidhen ndërmjet palëve. Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë kompetenca rregullatore gjatë këtij procesi.

3. Ujësjellësit që shërbejnë për furnizimin e fshatrave të një komune ose të një bashkie administrohen nga vetë njësitë e qeverisjes vendore, me përjashtim të rasteve kur komuna ose bashkia, miraton administrimin me një nga format e parashikuara në dokumentin e politikave për decentralizimin e ujësjellës-kanalizimeve.

4. Pas aparatit matës instalimi i ujit administrohet nga konsumatori familjar dhe konsumatori jofamiljar shtetëror ose privat.

5. Njësitë e qeverisjes vendore që marrin ujë të pijshëm nga degëzimet e ujësjellësve të qytetit përgjigjen vetë për mirëfurnizimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit nga pika e lidhjes deri tek konsumatori. Njësitë e qeverisjes vendore mbi bazën e sasisë të ujit që marrin sipas normave të regjistruara në matës, likuidojnë sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqërinë menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve.

II. VENDOSJA E APARATEVE MATËS TË UJIT

1. Lidhja për furnizimin me ujë të pijshëm e konsumatorit bëhet nga administratori i rrjetit ose menaxhuesi i shoqërisë, kur rrjeti i konsumatorit është ndërtuar sipas projektit të miratuar nga administratori dhe plotëson kushtet teknike e sanitare.

2. Konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë vetë matësit e ujit. Administratori ose menaxhuesi përcakton tipin dhe projektin e vendosjes. Vendosja kryhet me shpenzimet e konsumatorit nën mbikëqyrjen e administratorit midis të cilëve hartohet procesverbali dhe lidhet kontrata ndërmjet palëve.

3. Matësit e ujit për konsumatorët familjarë, instalohen nga administratori ose menaxhuesi i rrjetit mbi bazën e marrëveshjes ndërmjet palëve ku parashikohet edhe mënyra e pagesës si rezultat i vendosjes së tyre.

4. Administrimi dhe ruajtja e matësit të ujit, bëhet nga konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë. Në rast dëmtimi të tyre, konsumatori duhet të njoftojë me shkrim administratorin ose menaxhuesin e shoqërisë dhe të marrë masa për zëvendësimin e tij brenda afateve të parashikuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993.

5. Në rast se konsumatori nuk zbaton afatet për zëvendësimin e matësit dhe nuk paguan

gjohet e parashikuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993 administratori ose menaxhuesi, ndërpret furnizimin me ujë dhe kontrata ndërmjet palëve konsiderohet e zgjidhur.

6. Konsumatori në bazë të kontratës së lidhur me sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqërinë menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, duhet të paguajë për konsumin e ujit të pijshëm. Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e saj.

III. NDËRHYRJET NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

1. Përdoruesi i ujit të pijshëm nuk lejohet të bëjë shtesë të rrjetit të ujësjellësit që sjell harxhim të ujit pa marrë më parë leje nga sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve dhe njësia e qeverisjes vendore.

2. Punimet e lidhjes së ujit kryhen në prezencë të administratorit ose menaxhuesit të shoqërisë, kur përdoruesi i ujit është brenda vijës kufizuese të planit rregullues të qytetit apo fshatit.

3. Administratori ose menaxhuesi i ujësjellësve dhe kanalizimeve për meremetimet e planifikuara në rrjetin e jashtëm dhe të brendshëm të furnizimit me ujë është i detyruar të lajmërojë 15 ditë më parë përdoruesit e ujit, nëpërmjet medias dhe personelit të tij.

4. Sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-Kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë periodike me anë të punonjësve ose teknikëve të autorizuar prej tyre, duhet të kontrollojnë rrjetin e ujësjellësve dhe kur vërejnë mangësi të instalimeve dhe ndërhyrje në rrjet, të marrin masa të menjëhershme për riparimin e tyre, duke vënë përpara përgjegjësisë subjektet të cilat kanë ndërhyrë në rrjet pa miratimin e strukturave përgjegjëse.

5. Ndërtesat e banimit të projektohen detyrimisht me instalime të brendshme të ujit të pijshëm dhe aparate matëse të ujit. Ato të vendosen në vende të dukshme dhe të siguruara. Për rastet e ndërtimeve të reja aparati matës i ujit instalohet nga subjekti ndërtues, pas miratimit nga administratori ose menaxhuesi i shoqërisë.

IV. MBROJTJA E VEPRAVE DHE SIGURIMI HIGJIENO-SANITAR I UJIT TË PIJSHËM

1. Mbrojtja higjieno-sanitare e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm përfshin të gjitha veprat e ujësjellësit, prej zonës së ushqimit, zonës së vendburimit e deri te përdoruesit e ujit. Administruesit e ujit të pijshëm, duhet të bëjnë klorinimin e ujit sipas ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoratin sanitar shtetëror”. Në rastet e situatave të jashtëzakonshme me karakter epidemiologjik, kur ka rrezik për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, drejtoritë e shëndetit publik dhe të epidemiologjisë në qarqe caktojnë dozën e klorit të nevojshëm.

2. Administratorët e ujit pasi kanë marrë edhe miratimin e inspektoratit sanitar realizojnë mbrojtjen higjieno-sanitare të vendburimeve dhe depove të ujit sipas kushteve lokale:

- brezi i rreptësisë i cili rrethohet dhe bëhet i pakalueshëm, ky brez përfshin të gjitha veprat e marrjes së ujit, si kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, vaska grumbulluese e klorifikimi; në këtë zonë ndalohet çdo ndërtim, përveç atyre të domosdoshme për nevoja të ujësjellësit;

- brezi i mbikëqyrjes epidemiologjike, ku vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë që banon në këtë zonë.

3. Ndotja e ujit të pijshëm si rezultat i ndërhyrjes në objektet e ujësjellësit formon vepër penale. Struktura përgjegjëse (inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar) mban procesverbal dhe bën kallëzimin për ndjekje penale.

V. KONSTATIMI I LIDHJEVE DHE PËRDORIMI I UJIT NË MËNYRË TË PALIGJSHME

1. Përdoruesi i ujit për dëmtimet në rrjetin e brendshëm pas aparatit matës, merr masa të menjëhershme për ndreqjen e tyre.

2. Ndalohet çdo lloj manovrimi në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve nga persona që nuk janë të autorizuar nga administratori ose menaxhuesi i shoqërisë.

3. Ndalohet kategorikisht ndërtimi i objekteve mbi tubacionet e furnizimit me ujë dhe kanalizime, si dhe ndërhyrjet në sistemin e ujësjellësit e kanalizimit, lidhjet e pa miratuara nga manaxhuesi i licencuar dhe dëmtimet e çdo lloji.

4. Ndalohet kategorikisht përdorimi i ujit të pijshëm për lavazhet, ujitjen e tokës bujqësore, lagjen e trotuareve dhe rrugëve, nevoja teknologjike që nuk janë parashikuar në projekte.

5. Administratori ose menaxhuesi i shoqërisë për kundërvajtjet që konstaton gjatë shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, bashkërendon punën me njësinë e qeverisjes vendore, policinë e rendit, policinë ndërtimore dhe policinë bashkiake, duke marrë masa administrative apo denoncon për ndjekje penale për shkeljet e dispozitave që rregullojnë marrëdhëniet e shërbimit dhe furnizimin me ujë.

6. Sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqëria manaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellësave, duhet të kenë struktura të veçanta për ruajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimin e ujrave të përdorura nga ndërhyrjet e paligjshme. Konstatimet për ndërhyrjet apo përdorimin në mënyrë të paligjshme bëhen nga inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar, të cilët kanë autoritetin e vendosjes së gjobave të parashikuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993. Konstatimi, shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative apo ekzekutimi i vendimeve, kundër personave përgjegjës, që kryejnë kundërvajtje administrative bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

7. Ankimi kundër dënimit të marrë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993, për shkeljet e konstatuara në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, bëhen tek drejtori i ndërmarrjes së sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, shoqërisë manaxhuese të Ujësjellës-Kanalizimeve ose ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve. Pas marrjes së vendimit nga drejtori, subjekti ka të drejtë të ankohet në gjykatën e shkallës së parë në bazë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Kur shkeljet e konstatuara formojnë vepër penale, struktura përgjegjëse (inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar) mban procesverbalin dhe bën kallëzimin për ndjekje penale në bazë të nenit 159 të Kodit Penal.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Bashkim Fino